

**AKTI I THEMELIMIT I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Ilios” shpk**

Sot, Më datë 01/10/2022, shoqëria krijohet nga unë ortaku themelues:

Z.Erlind Metaj, shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal K00321075G, i datëlindjes 21/03/2000, lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

**Neni 1:
Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është “Ilios” shpk.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:
Objekti**

- 1) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në fushën e :

Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese të energjisë elektrike solare (fotovoltaike), energjisë së erës (eolike) dhe energjisë gjeotermale në Republikën e Shqipërisë dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Ministrive e Institucioneve të shtetit shqiptar i të gjitha miratimeve, lejeve dhe licencave të cilat mundësojnë zhvillimin e këtij aktiviteti në mënyre të qetë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë si dhe shërbime të tjera të ngjashme ose të lidhura me sa me sipër të cilat nuk ndalohen me ligj në Shqipëri dhe çdo lloj veprimtarie të ligjshme.

2) Shoqëria, në të ardhmen, gjithashtu mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të ligjshëm dhe që e gjykon të nevojshme.

**Neni 3:
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Rruga Zhan D’Ark , Ndërtesa 18, Nr.ap 41, Tiranë.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Neni 5:

*Faqe 1 e 2
Akti i Themelimit
“Ilios” shpk.*



Kapitali themeltar

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 10,000 (dhjetëmijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 (një) kuotë dhe nuk është paguar. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

Z.Erlind Metaj: Zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 10,000 lekë që përben 100% te kapitalit themeltar të shoqërisë.

- 2) Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6:

Administratori

- 1) Administrator i shoqërisë emërohet Z.Erlind Metaj, shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal K00321075G, i datëlindjes 21/03/2000, lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar. me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

Neni 7:

Baza Ligjore

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8:

Mosmarrëveshjet

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

ORTAKËT E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "Ilios" shpk

Erlind Metaj
(Emër, Mbiemër, Firma)

